

Konform nenit 5 dhe nenit 13, të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 04/l-174, nenit 12 alineja 1 dhe 2, nenit 17 alineja 1, pika b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 25, alineja 4, pika (b) dhe të nenit 27, alineja 1 të Statutit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2013, mori këtë:

V E N D I M PER MIRATIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR TË KOMUNËS SË PRIZRENIT

Neni 1

Me këtë Vendim bëhet miratimi i Planit Zhvillimor të Komunës (PZHK) së Prizrenit, që është hartuar nga ana e **OE-BP,,Urban Design Studio,, në Prizren (bartës i projektit) dhe "Plan Art,, e "ITU" (nënkontraktor) nga Stambolli (RP e Turqisë), e hartuar konform Ligjit mbi Planifikimin Hapësinor, nr.2003/14.**

Pjesë përbërëse e këtij Planit Zhvillimor të Komunës PZHK-së do të jetë elaborati me të gjitha shtojcat grafike dhe tekstuale.

Pjesa tekstuale do të përmban:

- Kushtet për rregullimin dhe destinimin e ndërtimit në këto hapësira,ndërsa .

Pjesa grafike duhet të përmbajë:

- Paraqitjet grafike të Planit Zhvillimor Komunal,si dhe mënyrën e zhvillimit te Qytetit dhe pjesës rurale ne kuadër te kufijve administrativ te Qytetit te Prizrenit .

Neni 2

Plani Zhvillimor i Komunës së Prizrenit përfshinë sipërfaqen e territorit të Komunës së Prizrenit $S= 640 \text{ km}^2$ (pjesën urbane të qytetit dhe pjesën rurale-74 fshatra), i cili PZHK do të inkurajojë strategjinë zhvillimore te Komunës se Prizrenit për periudhën 15- vjeçare-gjer me 2025.

Neni 3

Me Planin Zhvillimor Komunal(PZHK) nga neni 1 i këtij Vendimi planifikohet zgjidhja e hapësirës në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale për zhvillimin e ardhshëm të Qytetit dhe pjesës rurale ne kuadër te kufijve administrativ te Qytetit te Prizrenit, me qëllim që t'ju mundësojë qytetarëve jetën me planifikim urban dhe kushte te sigurta për investim.

Neni 4

Ky Vendim bashkë me dokumentacionin e përshkruar në nenin 1,dhe 2 të këtij Vendimi do të jetë pjesë përbërëse e Planit Zhvillimor Komunal për hapësirën e territorit te Qytetit të Prizrenit.

Neni 5

Plani Zhvillimor Komunal është hartuar për periudhën kohore më së paku 15- (pesëmbëdhjetë) vjeçare,ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Kryetari i komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do te shpallet ne “Kumtarë”.

KOMUNA E PRIZRENIT


Kuvendi i Komunës

Nr. 01/011-31340

Më 19 shtator 2013

P r i z r e n

Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu

The image shows a circular official stamp of the Prizren Municipality Council. The stamp contains the text "KOMUNA E PRIZRENIT" and "KUVENDI I KOMUNES". Overlapping the right side of the stamp is a handwritten signature in black ink, which appears to be "Nijazi Kryeziu".